ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK**

Për Aktivitetin e Prokurimit : **Angazhimi I stafit për nevoja të MKRS-së dhe Institucionet Vartëse**

LOT I-Automjetet e DAP-it dhe automjetet e QKMF-së

Nr[1] i prokurimit	**207-23-14360-2-1-1**
Nr i brendshëm	**207-23-153-2-1-1**

Sa i përket tenderit për : **Angazhimi I stafit për nevoja të MKRS-së dhe Institucionet Vartëse-LOT I –Zyrtarë për promovimin të TK në QRTK Ferizaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit *

BESNIK RRUSTEMI

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ferizaj

Rr.Sali Çeku,Union Invest,G47,Feruzaj ,70000 *(Kodi postar)*

044-855-624 _____

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Besnik Rrustemi

_____

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Besnikrrustemi1@gmail.com

(Adresa elektronike)

*24.07.2024*_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate : **23.12.2023**
Hapja e ofertave: **13.02.2024**
Njoftim mbi vendimin e AK : **29.02.2024**
Kerkesa per ri-shqyrtim: **05.03.2024**
Pergjigje e kerkeses per ri-shqyrtim : **08.03.2024**
Raporti I ekspertizes : **Nr.2024/0236 data 11.04.2024**
Vendimi I panelit Shqyrtues :**Nr. 2024-0236 data 02.05.2024**
Njoftimi mbi vendimin e AK-Rivlersim **: 09.07.2024**

Kerkese per ri-shqyrtim : **12.07.2024** Pergjigje e kerkeses per ri-shqyrtim :**15.07.2024** *Kriteri:* Tenderi ekonomikisht me I favorshem

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	x

Hapja e ofertave eshte bere permes sistemit elektronik e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x			**Jo**	☐

Po jemi njoftuar permes platformes elektronike e-prokurim

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK-ja
Neni 1 – Qellimi i ligjit; **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;** **Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi**

Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi **Neni 60 – Kriteret e dhenies** **Neni 69 – Kapaciteti teknik dhe/ose profesional** **Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi Ankimor numer 1.

Duke bazuar në njoftimin mbi vendimin e AK të dates 09.07.2024 konsideroj që edhe komisoni I **ri-vlersimin** nuk ka bërë vlersim të drejtë duke shkelur dispozitat ligjore të prokurimit public gjegjësisht nenin 1,6,7,59,60.

AK po mundohet të gjegjë forma të ndryshme vetëm e vetëm për të më eleminuar nga gara, prokurimi duhet të jetë ferë, pra ai I cili plotëson kriteret të përzgjedhet, unë kam shpenzuar shumë mund, kohë dhe kosto për të ndjekur shumë trajnime profesionale , ku kam arritur kualifikimet të larta, dhe për mua është e papranueshme që për të dyten here radhazi ky AK me eleminon nga gara vetëm e vetëm për të shperblyer me kontrat një konsulet tjetër.

Arsyjetimi I eleminimit është banal, kërkesa në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka qenë 120 ditë, ndërsa unë e kam plotësuar 36 muaj apo 1050 ditë, nuk është specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë që validiteti mos të jetë më shumë se 120 ditë, është specifikuar 120 ditë pra me këtë nënkuptojmë se 120 ditë është minumumi, pra 120 ditë janë më pak se 36 muaj, andaj konsideroj se jam eleminuar padrejtesishtë, ku AK ka shkelur dispozitat ligjore konkretisht nenin 7 dhe 59 të ligjit të prokurimit publik.

Nese kishte me qenë një minimum dhe një maksimum atëherë është në rregullë, mirepo meqenëse është specifikuar 120 ditë , atëherë validiteti imë është në rregullë.

Vlen të përmendet qe i njejti Autoritet Kontraktues, ka shpërblyer me kontratë dhe nënshkruar me kontratë me disa konsulent ku edhe ata e kanë plotësuar të njejtin validitet me të njejtet ditë, pra shihet haptazi që ky AK po mundohet të gjejë forma vetem për të më eleminuar mua, pra është intatosur vetëm me mua dhe nuk deshiron që unë të jem konsunet i kontraktuar nga ana e tyre sepse cakun e kan dikun tjetër, pikërisht për këtë arsyja edhe e ka mbajtur lënden në ri-vlersim gjerë e gjatë, gjegjësisht nga data 02.05.2024 ku AK eshte pajtuar me ekspertizën dhe OSHP ka nxjerr vendimin që lenden ta kthej në ri-vlersim, pra nga data 02.05.2024 AK ka mbajtur lëndën në ri-vlersim vetëm e vetëm për të eleminuar mua nga gara.

Të gjitha kushtet e kërkuara sipas dosjës së tenderit janë plotësuar në nivelet më të larta se të gjithë konkurrentët e tjerë,përshkrimi i çmimit është më I ulët se konkurrentët e tjerë.

Bazuar në nenin 18.4 të RRUOPP-së ku thotë : Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që operatorët ekonomik të interesuar duhet të dine

përgaditjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifiimet, kërkesat ,kriteretët, afatët kohore,metotologjinë,kushtet e kontratës,vizitat në lokacione ose takime para-tenderuese etj, të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës.Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mire,pasi që dosja e tenderit është material thelbësor,në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.Dosja e tenderit do të përgaditët në menyrë të tillë që-si rregull parimor të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.

Veçanërisht, Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh,kur përgaditet dosjes e tenderit,që mos të ketë komunikime,diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve.

Me rastin e përgaditjës se dokumentave të tenderit duhet kujdes të madhë në menyrë që të mos ketë dykuptimësi dokumentat/formularët e përgaditur nga AK dhe të sqarohet në menyrë sa më të detajuar dhe të jenë të kuptueshme të qarta për kandidatët e interesuar që duan të tenderojnë.

Gjithashtu duke pas parasysh rrethanat në të cilat janë pranuar ofertat nga Kandidatët në këtë aktivitet të prokurimit , AK ka qenë I obliguar të veproj sipas nenit 59 par.4 pika II të LPP-së, po citoj : përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime material ose devijime nga karakteristikat,kushtet, dhe kërkesat e tjera të pranueshme në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit me kushtë që,çfarëdo devijimi I tillë të kuantifikohet,aq sa është e mundëshme dhe të merret parasysh gjatë vlërsimit dhe krahasimit të tenderëve.

Gjithashtu sqaroj që edhe kandidatët e tjerë të cilët e kanë plotësuar formularin si unë kanë kaluar dhe janë shpërblyer me kontratë, mirëpo oferta ime nuk është trajtuar njejtë nga ana e komisionit të vlerësimit duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 par.2 të LPP-së po citoj :Autoritet Kontraktuese nuk do të egzekutojnë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në asnjë menyrë që redukton apo

eleminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mire të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të perdorën në menyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lënden e prokurimit,ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, Autoriteti Kontraktuese duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me të drejtë në shfrytezim të fondëve dhe burimeve publike.

Te gjitha faktet e paraqitura ne kete Ankesë jane te qendrueshme.

Përmes kësaj kerkese per Ankese ,Kerkojm nga ana e juaj që të merret :

V E N D I M

I APROVOHET si e bazuar Ankesa e **BESNIK RRUSTEMI**

II. OBLIGOHET AK Anuloj Njoftimin mbi vendimin e AK te dates 09.07.2024 dhe Lenda te kthehet ne RI-VLERSIM

III. Gjate fazes se RIVLERESIMIT, te REKOMANDOHEMI per kontrate sepse i plotesoj te gjitha kriteret e dosjes se tenderit dhe njoftimit ne kontrate.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri me tani shpenzimet per pergatitjen e ofertes,shpenzimet per paraqitjen e kerkeses per ri-shqyrtim dhe pergaditjen e ankeses ne organin shqyrtues te prokurimit eshte 1000 €
Duke llogaritur vleren e deponimit te ankeses, vleren e pergaditjes te dorezimit te ofertes,vleren e pergaditjes se kerkeses per ri-shqyrtim dhe vleren e pergaditjes se ankeses.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*